Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo
CAA

Nr. i prot. 2023/ZDP/450
Br.prot./Prot.Nr.
Faqe: 8 Kopje: — Datë: 20/12/2023
Stranica/Pages Kopija/Copy Datum/Date
Hyrës/ulazno/in ☐
Dalës/izlazno/out ☑
Brendshëm/interno/internal ☐
Prishtinë/Priština/Pristina

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Nr. 11/ZDP/VE/2023
Datë: 20 dhjetor 2023

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), nenit 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019"), nenit 13 dhe 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, dt. 10 shkurt 2016 ("Rregullorja") dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 28 prill 2014),

Duke vendosur sipas propozimit final të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("ASHNA"), dt. 27 nëntor 2023, për tarifën njësi terminale për vitin 2024,

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet miratimi i tarifës njësi terminale 2024 prej 413 EUR siç është propozuar nga ASHNA më dt. 27 nëntor 2023 (i ndryshuar dhe plotësuar më 1 dhjetor 2023).
2. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2024 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 361 EUR (360.59) EUR.
3. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që Agjencia ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës duke filluar nga data 1 janar 2024.
4. Obligohet ASHNA që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në investimet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2024.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2024, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentacionin si në vijim:

- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të parë (kostoja bazë fillestare për të dhënë shërbimin në vitin 2024 përmes tabelave të raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores 3/2016), më dt. 27 mars 2023 me numër protokolli 2023/ZDP/95;
- Konkluzionet e AAC-së nga përmbyllja e shqyrtimit rregullator të raportimit të parë të ASHNA-së sa i përket tarifës njësi 2024 të cilat i janë komunikuar ASHNA-s më 18 prill 2023;
- Raportin mbi pasqyrat financiare të ASHNA-s të dt. 06 prill 2023 për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2022 dhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të publikuar në maj 2023 për pasqyrat financiare të ASHNA-s për vitin 2022;
- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbim gjatë vitit 2024 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), më dt. 27 shtator 2023 me numër protokolli 2023ZDP/333;
- Dokumentet e përditësuara të dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë të plotësuar e ndryshuar (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbimin gjatë vitit 2024 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), më 03, 11, 22 tetor, 21, 22, 29 nëntor dhe 01 dhjetor 2023;
- Planin e aprovuar të trajnimeve të ASHNA-s për vitin 2024, i dërguar në AAC më 20 nëntor 2023;
- Planin vjetor të biznesit për vitin 2024 të ASHNA-s të dt. 1 dhjetor 2023 me numër protokolli 2023/BNRREA/421;
- Planin 5 vjeçar të biznesit (2024-2028) të ASHNA-s të dt. 1 dhjetor 2023 me numër protokolli 2023/BNRREA/422;
- Qarkoren buxhetore 2024/02 të MFPT, dt. 13 tetor 2023, si dhe kërkesën buxhetore të ASHNA-s 2024/26 bazuar në Qarkoren buxhetore 2024/02 për vitet 2024-2026 drejtuar MFPT të dt. 27 shtator 2023;
- Projektligjin mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2024, siç është miratuar nga Qeveria e RKS më 16 nëntor 2023;
- Raportin e shpenzimit të buxhetit janar-nëntor për ASHNA-n të datës 20 nëntor 2023;
- Parashikimin e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve për muajt e fundit të vitit 2023 si dhe të vitit 2024 të dorëzuar nga LKIA të dt. 22 nëntor 2023;
- Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2023 të dorëzuar nga ASHNA më 20 nëntor 2023;
- Të gjeturat nga inspektimi i datës 01 nëntor 2023 në ASHNA në lidhje me realizimin e projektit kapital "Pjesë rezervë për sisteme radarike" të financuar nga TNC 2022 dhe "Sistemi i ri i procesimit të të dhënave ATM" të financuar nga TNC 2023;
- Vendimi i MFPT me nr. 41 i dt. 21 shtator 2023 në bazë të të cilit kontrollorët e trafikut ajror aprovohen si profesionistë deficitar në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror, si dhe evidencën e pagës së ekzekutuar të një kontrollori të trafikut ajror për muajin tetor 2023;

- Raportin mbi propozimin e tarifës terminale njësi 2024 të hartuar nga ASHNA dhe të shpërndarë te kompanitë ajrore për konsultime në pajtim me nenin 15 të Rregullores nr. 3/2016 të AAC-së, dt. 8 nëntor 2023;
- Raportimin nga ASHNA të dt. 01 dhjetor 2023 se pas përmbylljes së afatit tre javor të konsultimit publik (9 nëntor - 30 nëntor 2023) në lidhje me përcaktimin e tarifës terminale, nuk kanë pranuar komente nga kompanitë ajrore;
- Informatat dhe dokumentacionin shtesë që është pranuar nga ASHNA përmes komunikimit elektronik në periudhën tetor-dhjetor 2023 me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2024 gjatë periudhës së shqyrtimit;

Pas shqyrtimit rregullator të secilës prej kategorive të kostove të propozuara në përputhje me metodologjinë dhe parimet e përcaktuara në Rregullore si dhe parashikimit të njësive që pritet të shërbehen gjatë vitit 2024, AAC ka konkluduar si në vijim:

Kostot për paga dhe mëditje:

Pas disa vlerave të ndryshme të dërguara gjatë muajit nëntor për koston e pagave, ASHNA në dokumentin e dërguar më 1 dhjetor 2023 përfundimisht ka propozuar një kosto prej 3.60 milion EUR për paga dhe mëditje të 192 punëtorëve që përfshin edhe pagesat për shtesat (stazhin, shtesat për punë jashtë orarit, shtesat për kushtet e tregut të punës dhe shtesat transitore 50%) për vitin 2024. Kjo kosto përfaqëson një rritje prej 22% në krahasim me përcaktimin e AAC-së për këtë kategori për vitin 2023 edhepse numri i punëtorëve të propozuar ka mbetur i njëjtë si për vitin 2023. Kostoja e propozuar është rritur, mes tjerash, për shkak të 12 studentëve kontrollorë që planifikohen të rekrutohen më 2024. Faktor i theksuar kontribues në koston e pagave që në vazhdimësi është rritur është pagesa për punë jashtë orarit që për vitin 2024 arrin vlerën 502,392.40 EUR. Ritheksojmë se kostoja e shtesave për punë jashtë orarit dhe festa gjatë viteve ka pasur këtë trend rritjeje: 293,900.62 EUR për vitin 2022, janë planifikuar 386,684.77 EUR për vitin 2023 respektivisht 502,392.40 EUR për vitin 2024. AAC kërkon që ASHNA të rrisë disiplinën e shpenzimit në këtë aspekt, sidomos të adresoj orët shtesë të cilat ngritin kostot.

Vendimi nr. 41 i dt. 21 shtator 2023 i MFPT ka njohur të drejtën e kontrollorëve të trafikut ajror që të përfitojnë shtesë për kushte të tregut të punës në përputhje me Rregulloren (MFPT) nr. 2/2023. ASHNA poashtu ka përfshirë në koston e pagave për vitin 2024 në formë parashikuese edhe shtesat për kushtet e tregut të punës për staf tjetër operativ për të cilat nuk ka ende Vendim të MFPT. Duke ditur rëndësinë e këtij stafi operativ për ofrimin e shërbimit AAC i ka konsideruar edhe këto kosto si të pranueshme duke iu referuar kërkesës që ASHNA ka bërë në MFPT në tetor 2023 dhe komunikimit se këto shtesa poashtu do të miratohen.

Duke pasur parasysh kërkesën e Rregullores, sipas të cilës vetëm kosto e stafit që pritet të japin shërbimin gjatë vitit 2024 duhet t'i ngarkohet kompanive ajrore, AAC-ja ka bërë një ri-kalkulim në të cilin janë marrë parasysh:

a) pagat e stafit që kthehen nga pushimi pa pagesë vetëm për muajt e vitit 2024 në të cilët do të japin shërbim;

A,2

b) shtesat duke përfshirë stazhin dhe shtesën për kushtet e tregut në bazë të Vendimit nr. 41 të MFPT;
c) shtesat transitore (50%); dhe
d) vlerën monetare të koeficientit për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik të përcaktuar në vlerën (110 €) euro në bazë të projektiligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024,

Pas rikalkulimit, AAC ka përcaktuar si të arsyeshme një kosto prej 3.59 milion EUR për paga, shtesat në paga dhe kompensimet tjera. Numri i përcaktuar i personelit është 192 aq sa ka përcaktuar projektligji për ndarjet buxhetore 2024 për ASHNA-n.

Kostot tjera operative:

Parashikimi i këtyre kostove nga ASHNA është përshkuar me jokonsistencë për shkak se këto kosto vazhdimisht kanë pësuar ndryshime duke demonstruar planifikim jo të duhur. Në raportimin e parë ASHNA ka parashikuar kosto prej 6.7 milion EUR, në raportimin e dytë 2.73 milion EUR ndërsa në raportimet e mëtejme të plotësuara e ndryshuara ka propozuar kostot operative në vlerë prej 2.76 milion EUR apo 21% më shumë se sa ka përcaktuar AAC-ja për vitin 2023. AAC ka shqyrtuar listën e shpenzimeve operative që mban vlerën totale prej 2.76 milion EUR në të cilën ka vërejtur se sikur edhe vitin e kaluar linjat me koston më të lartë janë Trajnimet (790,233 EUR) dhe Mirëmbajtja (664,000 EUR).

Gjatë shqyrtimit të realizimit të buxhetit për vitin 2023 është konstatuar që ASHNA deri më 20 nëntor të vitit 2023 ka realizuar vetëm 77,152 EUR të linjës së trajnimeve nga 566,750 EUR sa ishin aprovuar nga AAC-ja kryesisht për shkak të mosrekrutimit/trajnimit të 12 kontrollorëve të rinj. Sa i përket mirëmbajtjes, vërehet që nga 437,000 EUR sa janë aprovuar nga AAC-ja për vitin 2023 deri më 23 nëntor 2023 janë shpenzuar vetëm 177,406 EUR.

Pasi ka shqyrtuar secilën linjë të kostove operative të parapara për vitin 2024 dhe raportin e realizimit të buxhetit gjatë vitit 2023, dhe duke pasur parasysh metodologjinë e rregullores sipas së cilës kompanitë ajrore nuk do të paguajnë më tepër sesa kostot e shkaktuara, AAC-ja ka përcaktuar si të arsyeshëm një buxhet operativ prej 2.49 milion EUR për vitin 2024 që përfshin edhe shpenzimet komunale prej 164,000 EUR.

Kostoja e zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit:

ASHNA ka propozuar që kosto e kapitalit dhe zhvlerësimit për vitin 2024 të jetë 813,329 EUR. AAC ka vërejtur se lista e aseteve të rregulluara është përditësuar për të përfshirë asetet që janë financuar nga tarifa terminale e navigacionit 2023 (Sistemi i procesimit të të dhënave). Sidoqoftë, këtij projekti i është kalkuluar dyfish zhvlerësimi sepse është paraqitur si në listën e aseteve aktuale ashtu edhe te asetet e reja që pritet të hyjnë në shërbim gjatë vitit 2024. Pas njohjes së zhvlerësimit të këtij projekti vetëm te asetet aktuale si dhe përmirësimit të disa gabimeve në përllogaritje del se vlera e zhvlerësimit të aseteve aktuale dhe atyre të reja që pritet të hyjnë në shërbim të kompanive ajrore është 660,761 EUR.

Kostoja e kapitalit të propozuar nga ASHNA në vlerë prej 210,317 EUR poashtu është ndryshuar për të reflektuar kalkulimin e dyfisht të përmendur në paragrafin më lartë si dhe projektet

kapitale të aprovuara nga AAC për t'u financuar nga tarifa në vitin 2024 duke rezultuar në vlerën prej 168,427 EUR.

Sa i përket mesatares së ponderuar të normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali ASHNA në raportimin e dytë të dt. 27 shtator ka propozuar që të jetë 3.40%, ndërsa në plotësim ndryshimin e këtij propozimi të datës 01 dhjetor 2023 ka propozuar 3.60% duke mos treguar se si kanë ardhë te kjo vlerë. Në bazë të shtojcës 3 të Manualit të ICAO-s mbi ekonominë e shërbimeve të navigacionit ajror dhe seksionit 1 të pikës 4 të Udhëzuesit të EUROCONTROL-it mbi sistemin e tarifave të rutave, AAC-ja ka analizuar obligacionet qeveritare 7 dhe 10 vjeçare të Bankës Qendrore të Kosovës dhe gjatë vitit 2023 nuk ka pasur aukcion të obligacioneve 10 vjeçare prandaj do të mirret mesatarja e vitit 2022 e cila është 3.35%. Në bazë të këtyre të dhënave AAC-ja ka vendosur që mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe kthimit të kapitalit të jetë 3.35%.

Pas finalizimit të listës së rregulluar të aseteve, kalkulimit të zhvlerësimit dhe kostos së kapitalit si për asetet që janë në funksion më 2023 ashtu edhe për ato që planifikohen të futen në funksion gjatë 2024 dhe aplikimit të normës prej 3.35%, AAC-ja ka përcaktuar që kosto e zhvlerësimit dhe kosto e kapitalit për vitin 2024 të jetë 829,187 EUR.

Projektet kapitale të aprovuara:

ASHNA ka treguar planifikim jo të duhur sa i përket projekteve kapitale që propozojnë të financohet nga tarifa terminale e navigacionit më 2024 gjë që ka vështirësuar në masë të madhe edhe shqyrtimin objektiv të AAC mbi këtë kosto. ASHNA gjatë të gjitha raportimeve (mars-nëntor 2023) nuk ka paraqitur përmes tabelave raportuese ndonjë projekt kapital që të financohet nga tarifa. Më 29 nëntor 2023 pas pyetjeve të parashtruara nga AAC-ja në lidhje me projektet kapitale të cilat planifikojnë t'i realizojnë përmes tarifës ASHNA ka dorëzuar një listë të projekteve kapitale në vlerë prej 1.885 milion EUR për të cilat ASHNA nuk ka dorëzuar arsyeshmëri. AAC ka analizuar dokumentin e Kërkesës buxhetore nr. 2024/26 që ASHNA ka dorëzuar në MFPT ku kemi gjetur të dhëna dhe arsyeshmëri jo të plotë mbi këto projekte. Sidoqoftë më 13 dhe 14 dhjetor 2023 ASHNA ka dhënë/dorëzuar një arsyetim final sa i përket investimit për energji të ripërtëritshme.

AAC ka analizuar këtë listë të projekteve kapitale, arsyeshmërinë në dispozicion si dhe nivelin e realizimit të projekteve kapitale të monitoruar ndër vite dhe ka vendosur që t'i pranoj si kosto të arsyeshme projektet kapitale në vlerë prej 1,885,034 EUR në funksion të ofrimit të shërbimit për kompanitë ajrore si në vijim:

Projekti	Vlera e përgjithshme
Furnizimi me radio për sistemin e komunikimit tokë-tokë	5,550 EUR
Automjete për nevoja të ASHNA-s (për nevoja operative)	180,000 EUR
Furnizimi me inventar për nevoja operative	50,000 EUR
Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës	4,484 EUR
Pajisje për Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice +Data	50,000 EUR
Furnizim me KVM sëitch.	35,000 EUR
Upgrade i Radarit në Golesh	1,200,000 EUR
Energji e ripërtëritshme	360,000 EUR

Gjithsej	1,885,034 EUR

Në kuadër të kostos totale të zhvlerësimit dhe të kostos së kapitalit për vitin 2024, 127,817 EUR janë përfshirë si kosto të ASHNA-s për këto projekte kapitale me pritshmëri që të jenë në funksion për kompanitë ajrore gjatë vitit 2024.

BNRREA do të inspektojë realizimin e këtyre projekteve kapitale në vitin e ardhshëm. ASHNA obligohet që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në projektet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2024.

Parashikimi i njësive terminale të shërbimit (TSU) 2024:

ASHNA ka parashikuar rritje të TSU-ve prej 7% për vitin 2024, respektivisht ka parashikuar se do t'i shërbejë 15,749 njësi nga 14,719 njësi sa ka raportuar në Tabela Raportuese se do t'i shërbejë gjatë vitit 2023. Sidoqoftë, në Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2023 të dorëzuar më 15 nëntor 2023 ASHNA ka raportuar se do t'i shërbejë 15,449 njësi gjatë vitit 2023 gjë që përbën dallim të madh prej 14,719 njësi sa i kanë deklaruar në Tabela Raportuese që ka ndikuar edhe në propozimin joreal të tarifës për vitin 2024.

Parashikimi i saktë i bazës së TSU-ve (viti aktual apo n) është me rëndësi të veçantë për ASHNA pasiqë parashikimi për vitin (n+1) ndërtohet mbi të, ndërsa konstatimi i gabuar nënkupton axhustime të mëdha në vitin n+2.

ASHNA ka vendosur rritjen e parashikuar të TSU prej 7% në krahasim me vitin 2023 por nuk ka sqaruar se në bazë të çfarë burimi ka ardhë deri te ky parashikim.

Operatori i aeroportit në komunikim drejtuar AAC-së dhe ASHNA-s ka parashikuar se viti 2023 do të përmbyllet me afër 3,4 milion udhëtarë të shërbyer (14% rritje në krahasim me 2022), respektivisht 11,224 nisje të fluturimeve (4% rritje në krahasim me 2022). Sipas LKIA, numri i udhëtarëve në vitin 2024 parashihet të ketë një ngritje prej 14% në krahasim me vitin 2023 ndërsa numri i fluturimeve të ngritet për 17% (nën parashikimin e faktorit të ngarkesës 80% në krahasim me 82% sa ishte gjatë 10 muajve të parë të vitit 2023). Ky parashikim është bazuar në Orarin e fluturimeve për sezonin dimër 2023/2024 dhe aplikimeve të pranuara nga kompanitë ajrore për sezonin e verës të vitit 2024. Parashikimi poashtu është ndërtuar nën faktin se në vitin 2024 në zonën Schengen shtetasit e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza.

AAC-ja ka bërë një kalkulim mbi trafikun dhe numrin e parashikuar të TSU-ve gjatë vitit 2024 duke u bazuar në të dhënat dhe parashikimin e trafikut (numri i udhëtarëve dhe fluturimeve) nga operatori i aeroportit LKIA si të dhënat më mirë të informuara të numrit të fluturimeve. AAC-ja pret që viti 2023 të përmbyllet me 15,254 njësi terminale të shërbimit ndërsa gjatë vitit 2024 parashikon që do të shërbehen 17,389 njësi terminale që i bie 14% më shumë se në vitin 2023.

Përshtatja për vitin 2022:

Në bazë të Aneksit VI të Rregullores nënmbulimi ose mbimbulimi si rezultat i diferencës midis të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2022 fillon të bartet/ përshtatet në vitin 2024.

Sa i përket përshtatjes, gjatë raportimeve ASHNA ka paraqitur mbimbulim kostoje për vitin 2022 prej 944,706 EUR dhe ka propozuar që kjo vlerë të kthehet në 5 vite por nuk është dhënë arsyetim mbi këtë propozim.

Në bazë të pasqyrave financiare të ASHNA-s të vitit 2022, përshtatjes përkatëse të zhvlerësimit dhe kostos së kapitalit për projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2022, si dhe përshtatjes nga vitet e kaluara, rezulton se ASHNA ka mbyllur vitin 2022 me një bilanc prej 946,021 EUR. Kjo vlerë do të shtrihet në 4 vite (236.505 EUR secili), dhe do t'i shtohet kësti i mbimbulimit nga viti 2020 në vlerë prej 87,480 EUR dhe kësti nga viti 2021 në vlerë prej 70,327 EUR, që do të rezultojë me 394,312 EUR vlerë që ASHNA duhet t'ia kthej kompanive ajrore gjatë vitit 2024.

Duhet të kihet parasysh që mbimbulimi, në përputhje me pikën 67 të Manualit të EUROCONTROL për tarifa, konsiderohet borxh ndaj përdoruesve dhe si i tillë duhet të bëhet përpjekje që t'u kthehet përdoruesve (kompanive ajrore) në një kohë të arsyeshme, veçanërisht duke konsideruar kapacitetin aktual të ASHNA-s për ta kthyer këtë borxh. Duke pasur parasysh se në vitet në vazhdim parashihet një rritje më e theksuar e trafikut, AAC përcakton që është kohë e duhur për ASHNA-n që ta shfrytëzojë këtë moment dhe t'ua kthej borxhin kompanive ajrore gjatë 4 viteve të ardhshme.

Në bazë të këtyre fakteve dhe konsiderimeve dhe duke pasur parasysh:

- Se propozimi i ASHNA-s për tarifë terminale 2024 në vlerë prej 413 EUR i llogaritur nën parashikimin e rritjes së njësive të shërbimit më 2024 për 7% nën bazën prej 15,749 njësive përfaqëson një rritje tarife prej 9% krahasuar me tarifën e vitit 2023 në vlerë prej 380 EUR;
- Se ASHNA obligohet sipas Rregullores që të dëshmojë përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të kostove që në kushtet e rritjes së trafikut nënkupton ulje të tarifës për njësi;
- Vendimin nr. 05-V-286, dt. 26 maj 2016, përmes të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka udhëzuar AAC-në të ndërmarrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit;
- Se AAC-ja ka për qëllim të vendosë një balancë midis operatorëve që japin shërbime nën kushtet e monopolit natyror dhe atyre që i pranojnë këto shërbime;
- Nxitjet financiare të ofruara nga operatori i aeroportit dhe të aprovuara nga AAC-ja për të rritur atraktivitetin e aeroportit;

AAC ka vendosur se:

- Tarifa njësi terminale për vitin 2024 të jetë 361 EUR (360.59 EUR vlera e saktë)
- Nën parashikimin prej 14% të rritjes së numrit të njësive të shërbyera terminale gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023, kostot totale të ASHNA për të dhënë shërbim cilësor dhe të sigurt gjatë vitit 2024, të pranueshme për AAC pritet të jenë 6.9 milion EUR. Këto kosto do të mbulohen nga tarifa terminale e navigacionit dhe të hyrat tjera.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë, dhe në pajtim me nenin 15.1 (f), 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të

A?.

Navigacionit Ajror, si dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Alban Ramabaja
Ushtrues i detyrës së Drejtorit të përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik: Në përputhje me nenin 15.7 të Rregullores nr. 3/2016, brenda 7 ditëve nga data e lëshimit të këtij Vendimi, ASHNA mund të ri-dorëzojë për miratim në AAC propozimin e ri për tarifën njësi terminale për vitin 2024 përmes Tabelave të Raportimit dhe narrativit që përshkruan në hollësi kalkulimin e secilës prej kostove të pranueshme dhe dëshmon nevojën për t'u realizuar këto kosto gjatë vitit 2024. Propozimi i ri duhet të dërgohet në origjinal të shtypur dhe në kopje elektronike në AAC.

Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, MFPT
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"
- Arkivit të AAC-së